



Në bazë të nenit 103, pika 2 të Ligjit për arsimin e lartë („Gazeta zyrtare e RMV”, nr.82/18), Dekretit me fuqi ligjore për zbatimin e Ligjit për arsim të lartë në gjendje të jashtëzakonshme („Gazeta zyrtare e RMV” nr.76/2020), Dekretit me fuqi ligjore për ndryshimin dhe plotësimin e Dekretit me fuqi ligjore për zbatimin e Ligjit për arsim të lartë në gjendje të jashtëzakonshme („Gazeta zyrtare e RMV “ nr.116/2020), Dekretit me fuqi ligjore për ndryshimin dhe plotësimin e Dekretit me fuqi ligjore për zbatimin e Ligjit për arsim të lartë në gjendje të jashtëzakonshme („Gazeta zyrtare e RMV “ nr. 149/2020), të nenit 131 dhe 185 të Statutit të Universitetit të Tetovës, nenit 15 Rregullores për kushtet, kriteret dhe rregullat për studim në ciklin e tretë-studime të doktoraturës në Universitetin e Tetovës, Vendimit nr. 02-998/1, nga mbledhja e Këshillit të Rektoratit, e mbajtur më 24.03.2020, Vendimit të Qeverisë së RMV-së për dhënien e pëlqimit për konkurset për regjistrimin e studentëve në ciklin e tretë të studimeve në institucionet publike të arsimit të lartë, nr. 44-6081/1 të datës 19.06.2020 (Gazeta zyrtare e RMV nr. 166/2020), Universiteti i Tetovës shpall:

KONKURS

për regjistrimin e studentëve në ciklin e tretë të studimeve-studime të doktoraturës në programet studimore të Universitetit të Tetovës në vitin akademik 2020/21

I. Programet studimore, numri i studentëve dhe lartësia e kompensimit financiar për studime

Cikli i tretë i studimeve 2020/21			
PROGRAMET STUDIMORE (ORGANIZATORI)	ECTS	Numri i studentëve	Kompensimi financiar (euro)*
Shkenca mbi gjuhën-Fakulteti Filozofik	180	3	5650
• Filologji orientale*			
Sociologji -Fakulteti Filozofik**	180	5	5650
• Moduli sociopolitik			
• Moduli sociokulturor			
Pedagogji-Fakulteti Pedagogjik	180	3	5650
• Strategjia e zhvillimit të arsimit			
• Strategjia e zhvillimit të mësimdhënies			
UNIVERSITETI I TETOVËS	Gjithsej	11	

*1 mentor në proces të akreditimit;

**1 mentor në proces të akreditimit;

II. Kushtet dhe mënyra e regjistrimit të studentëve

Të drejtë regjistrimi në studimet e ciklit të tretë-studime të doktoraturës kanë personat që kanë kryer programe studimore adekuat në ciklin e parë dhe të dytë dhe që i përmbushin këto kriteret:

- Të kenë të kryer ciklin e dytë të studimeve në përputhje me Sistemin Evropian të Kredive (në tekstin e mëtutjeshëm: ECTS kredi)
- Të kenë të kryera studimet pasdiplomike në programet studimore para implementimit të ECTS kredive, të cilëve u pranohen 60 kredi nga pjesa e trajnimit për hulumtim dhe edukim;
- Të kenë përgatitje profesionale sipas programeve studimore të profesioneve të rregulluara, me së paku 300 ECTS kredi;
- Të kenë notën mesatare të suksesit më së paku 8.00 nga të gjitha lëndët nga arsimimi i lartë, i kryer paraprakisht. (Cikli i parë dhe i dytë i studimeve, përkatësisht nga studimet deridiplomike dhe pasdiplomike si dhe studimet e integruara);
- Të njohin një nga gjuhët botërore, gjë e ciladëshmohet me certifikatë ose vërtetim nga ana e një institucioni adekuat arsimor, certifikatë ndërkombëtare ose me diplomë nga arsimimi paraprak i kryer në njërin nga gjuhët botërore - studime të ciklit të parë (studime deridiplomike) ose studime të ciklit të dytë (studime pasdiplomike);
- Shtetasit e huaj kanë të drejtë regjistrimi në studimet e ciklit të tretë-studime të doktoraturës, sipas kushteve të përcaktuara në Ligjin për arsim të lartë („Gazeta zyrtare e RMV”, nr.82/18),.

III. Mënyra e financimit

- Kompensimi financiar i studimeve të ciklit të tretë është tërësisht në ngarkesë të studentit dhe kushton 5650 EURO (përlogaritur në denarë sipas kursit të mesëm të BP RMV në ditën e pagesës);
- Kompensimi financiar paguhet në 6 këste të barabarta, në fillim të çdo semestri, në kundërvlerë në denarë;
- Shpenzimet të cilat dalin nga shfrytëzimi i laboratorëve të universitetit, gjatë përgatitjes së punimit të doktoraturës, specifikohen në mënyrë të veçantë dhe të njëjtat kandidati i kompenson deri në mbrojtjen e punimit të doktoraturës.

IV. Përzgjedhja e kandidatëve

- Procedurën për përzgjedhje kandidatëve në ciklin e tretë-studime të doktoraturës e realizon Komisioni qendror për regjistrim;
- Rangimin e realizon Komisioni qendror për regjistrim;
- Ranglista preliminare publikohet në tabelën e shpalljeve të universitetit dhe në ueb faqen e Universitetit të Tetovës;
- Kandidati i cili konsideron se procedura nuk është realizuar drejt, ka të drejtë ankese me shkrim deri te Komisioni qendror për regjistrim, në afat prej 36 orësh nga dita e publikimit të rezultateve në tabelën e shpalljeve të universitetit;
- Vendimi nga ankesa sillet në afat prej 36 orëve nga momenti i sjelljes së saj dhe e njëjta i dorëzohet parashtruesit të ankesës;
- Në bazë të listës së përgatitur dhe pëlqimit me shkrim të mentorëve, Komisioni qendror për regjistrim sjell vendimin për regjistrimin e kandidatëve në ciklin e tretë-studimet e doktoraturës;
- Lista përfundimtare e kandidatëve të pranuar, publikohet në tabelën e shpalljeve të universitetit dhe në ueb faqen e universitetit;
- Kandidatët të cilët në afatin kohor të paraparë për regjistrim, nuk e bëjnë regjistrimin, respektivisht nuk dorëzojnë dokumentacionin e duhur për regjistrim ose fare nuk paraqiten, do të konsiderohen se kanë hequr dorë nga regjistrimi.

V. Dokumentet për aplikim

- Fletaplikimin kandidatët e plotësojnë online në ueb faqen e universitetit në linkun <http://www.unite.edu.mk/apply> (Regjistrimet 2020/21) dhe gjatë plotësimit duhet t'ibashkëngjisin (attach) të skanuara këto dokumente (duhet të skanohen të plota dhe të jenë të lexueshme);
- Vërtetim për pagesë të: 1850 denarëve në xhirollogarinë e Universitetit të Tetovës, në emër të taksave administrative;
- Letër motivimi në të cilën theksohet lëmi i studimit;
- Listë të punimeve shkencore ose profesionale dhe kopje nga të njëjtat (nëse kandidatët kanë të tilla);
- Biografi e shkurtër;
- Rekomandime nga profesorë ose punonjës shkencorë (nëse i posedon ato);
- Certifikatë shtetësie;
- Certifikatë lindjeje;
- Vërtetim për përvojë pune dhe për llojin e detyrave të cilat i ka ushtruar gjatë punës;
- Certifikatë për provimet e dhëna në ciklin e parë, përkatësisht në studimet deridiplomike;
- Diplomë të ciklit të parë, përkatësisht të studimeve deridiplomike;
- Certifikatë për provimet e dhëna në ciklin e dytë të studimeve, përkatësisht studimeve pasdiplomike;
- Diplomë e ciklit të dytë të studimeve, përkatësisht studimeve pasdiplomike;
- Certifikatë/vërtetim për njohjen e një gjuhe botërore nga institucion arsimor adekuat ose certifikatë e pranuar ndërkombëtarisht (TOEFL, IELTS, TOLES, ILEC, CSPE);
- Kandidatët të cilët arsimimin e tyre të lartë, studimet e ciklit të parë (studime deridiplomike) dhe studimet e ciklit të dytë (studimet pasdiplomike) i kanë përfunduar jashtë vendit, dorëzojnë dëshmi për nostrifikim të dokumenteve dhe ekuivalentim të notave.
- Pëlqim preliminar të mentorit potencial nga lista e mentorëve të akredituar, e shpallur në ueb faqen e universitetit-<http://unite.edu.mk>, në pjesë për studimet e ciklit të tretë-studimet e doktoraturës dorëzohet pas shpalljes së ranglistës preliminare në formë të skanuar në email adresën: doktoratura@unite.edu.mk.;

VI. Dokumentet për regjistrim:

Gjatë regjistrimit, kandidatët i dorëzojnë në origjinal ose kopje të vërtetuara në noter të gjitha dokumentet të cilat gjatë aplikimit janë dorëzuar të skanuara si dhe në mënyrë plotësuese :

- Fletëparaqitje për regjistrim (formularët merren në Zyrën për studime të doktoraturës, Rektorati i UT-së);
- 3 fotografi (2 nga 6x9; 1 nga 4x5);
- Vërtetim për pagesën e; **1500denarëve**, në xhirollogarinë e Universitetit: në emër të dhënies së Index-it;
- Vërtetim për pagesën e kështit të parë të kompensimit financiar.

Të gjitha pagesat e lartpërmendura për **ciklin e tretë** do të kryhen në xhirollogarinë e Universitetit, në këtë mënyrë:

- Në "emri i marrësit" (назив на примачот) - Universiteti i Tetovës,
- Në „banka e marrësit“ (банка на примач) – Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut,
- Në „llogaria“ (сметка) – 10000000063095,
- Në „shuma“ (износ) – shuma e mjeteve financiare që duhet të paguhen,
- Në „llogaria e shfrytëzuesit buxhetor- subjekti shfrytëzues“ (сметка на буџетски корисник – единка корисник“ – 1600160054 788 25;
- Në „shifra dhe programi i të hyrave“ (приходна шифра и програма) – 723012 43, ndërsa në „mënyra“ (начин) – 2;
- Në „thirrja në numrin“ (повикување на број – задолжување) shënohet numri, në këtë mënyrë:
- 723012 – 15: Cikli i tretë i studimeve-studime të doktoraturës
- Në rubrikën: qëllimi i realizimit të pagesës (цел на дознака) – qëllimi i pagesës (kësti i parë, Index, aplikim etj).

VII. Afatet për paraqitje dhe regjistrim

REALIZIMI I KONKURISIT PËR REGJISTRIM TË STUDENTËVE NË CIKLIN E TRETË 2020/21	Afatet
Paraqitja e kandidatëve	14 - 25 shtator 2020
Shpallja e listës preliminare	05 tetor 2020
Vendimet për ankesat	13 tetor 2020
Pëlqimi preliminar i mentorit potencial nga lista e mentorëve të akredituar	05 -12 tetor 2020
Shpallja e listave përfundimtare	13 tetor 2020
Regjistrimi i kandidatëve	14 -16 tetor 2020

Dokumentacionii lartpërmendur gjatë regjistrimit të studentëve të pranuar dorëzohet në Zyrën për studimet e doktoraturës, Rektorati i UT-së. Rruga e Ilindenit p.n. 1200 Tetovë.

VËREJTJE:

Informacione të detajuara për kushtet e regjistrimit, dokumentacionin e nevojshëm dhe programet studimore, kandidatët e interesuar mund të marrin në Zyrën për studime të doktoraturës në Rektoratin e Universitetit të Tetovës ose në ueb faqen e universitetit.

Telefoni për kontakt: 044-356-500 Universiteti i Tetovës

Konkursi do të shpallet në ueb faqen: <http://www.unite.edu.mk>, Tetovë, korrik 2020